

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **Keshilli Prokurorial i Kosovës**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **250-26-4064-2-2-1**

Sa i përket tenderit për **Mirëmbajtja dhe Servisimi i Ashensorëve në objektet e sistemit Prokurorial të Republikës së Kosovës**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj	" EJONA " SH.P.K.
NUI	810089913
Adresa	Zahaq
Vendi	Peja
Kodi postar	30000
Numri Telefonit	049137987
Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj	Ejona Prelvukaj
Adresa elektronike	info@ejona.com
Data e parashtrimit të ankesës	19.08.2026

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

Emri i avokatit
Adresa e plotë
Numri i Telefonit
Numri i faks-it
Adresa elektronike

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës” “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit”, apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

Ankesa i përket grupeve:

Mirëmbajtja dhe Servisimi i Ashensorëve në objektet e sistemit Prokurorial të Republikës së Kosovës

08.06.2026 Njoftim per Kontrat

02.07.2026 Hapja e ofertave

21.07.2026 Vendimi i AK 1

31.07.2026 Vendimi i AK 2

10.08.2026 Refuzimi i kërkeses per Rishqyrtim

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐

Jo ☒

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☒

Jo ☐

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒

Jo ☐

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontestit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se.

Në kuadër të kontestit paraprak për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, OE EJONA SH.P.K. ka paraqitur dy kërkesa për rishqyrtim pranë Autoritetit Kontraktues.

Që në kërkesën e parë për rishqyrtim kemi ngritur pretendimin lidhur me dokumentacionin e inxhinierit Fatjon Beqa, i cili ishte përfshirë nga OE UP LIFT në listën e stafit për aktivitetin konkret, së bashku me diplomën, licencën, CV-në dhe një marrëveshje të cilat i referojë një aktiviteti tjetër të prokurimit. Për më tepër,

vetë inxhinieri na ka konfirmuar me shkrim se për aktivitetin në fjalë nuk kishte marrëveshje paraprake me kompaninë UP LIFT.

Pavarësisht provave të paraqitura, AK nuk e ka marrë për bazë dhe nuk e ka trajtuar këtë pretendim në vendimin e parë, duke mos bërë verifikimin e dokumentacionit dhe duke mos dhënë arsyetim lidhur me këtë çështje.

Për këtë arsye, të njëjtin pretendim e kemi ngritur përsëri edhe në kërkesën e dytë për rishqyrtim, duke kërkuar shprehimisht nga AK që të verifikojë nëse OE UP LIFT kishte autorizim të vlefshëm për përfshirjen e këtij personi në listën e stafit dhe për përdorimin e dokumenteve të tij në aktivitetin konkret.

Megjithatë, edhe në vendimin e dytë AK nuk e ka marrë për bazë këtë pretendim dhe nuk ka bërë verifikimin e kërkuar, me arsyetimin se OE UP LIFT tashmë ishte eliminuar për një arsye tjetër.

Konsiderojmë se fakti që OE është eliminuar për një shkelje tjetër nuk e bën të parëndësishëm pretendimin për paraqitjen e dokumentacionit të kontestuar, veçanërisht kur ky pretendim lidhet edhe me vërtetësinë e dokumentacionit të dorëzuar dhe respektimin e Deklaratës nën Betim.

Prandaj, këtë çështje e paraqesim për shqyrtim pranë OSHP-së, pasi AK është njoftuar dy herë për këtë pretendim dhe për provat përkatëse, por në asnjërën prej dy procedurave të rishqyrtimit nuk ka bërë verifikimin e tij në substancë.

Bashkëngjitur paraqesim kopjet e vendimeve të Autoritetit Kontraktues të nxjerra gjatë procedurës paraprake të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve, në përputhje me nenin 108/A të LPP-së.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënie të Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Dispozitat e shkelura:

PRETENDIMI 1)

Neni 7 i LPP-së;

Neni 59 paragrafi 4 i LPP-së;

Neni 60 paragrafi 1 i LPP-së;

Neni 40 i Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

PRETENDIMI 2)

Deklarata nën betim

Neni 59 paragrafi 2 i Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik;

Neni 59 paragrafi 4 i Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik;

Neni 69 i Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik;

Neni 72 i Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik;

Neni 99 paragrafi 2 i Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik.

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjabë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë të rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

PRETENDIMI NR. 1

Eliminimi i OE EJONA SH.P.K. është i kundërligjshëm dhe oferta jonë vazhdon të jetë e përgjegjshme

Dispozitat e shkelura:

Neni 7 i LPP-së;

Neni 59 paragrafi 4 i LPP-së;

Neni 60 paragrafi 1 i LPP-së;

Neni 17.35 i Rregullores për Prokurimin Publik;

Neni 27.12, 27.14 dhe 27.15 i Rregullores për Prokurimin Publik.

Faktet

Në vendimin e parë të Autoritetit Kontraktues, oferta e OE **EJONA SH.P.K.** është konsideruar ofertë e përgjegjshme. Në atë fazë, AK nuk ka konstatuar asnjë mangësi lidhur me çmimin e ofertës sonë dhe as tejkalim të vlerës së parashikuar të kontratës.

Kontrata ishte rekomanduar për OE **UP LIFT** vetëm për shkak se oferta e tij ishte renditur me çmim më të ulët.

Pas kërkesës sonë të parë për rishqyrtim, AK ka konstatuar se OE **UP LIFT** duhet të eliminohet për shkak të çmimeve për njësi prej **0.00 €** në disa pozicione të paramasës. Vetëm pas eliminimit të OE **UP LIFT**, AK ka ndryshuar qëndrimin ndaj ofertës së **EJONA SH.P.K.** dhe për herë të parë ka konstatuar se edhe oferta jonë duhet të eliminohet, duke

marrë për bazë shumën aritmetike të papeshuar prej **43,173.60** .

Ky ndryshim është bërë pa pasur asnjë ndryshim në ofertën tonë financiare, në çmimet për njësi, në paramasë apo në metodologjinë e vlerësimit.

Oferta jonë ka qenë e njëjtë në të dy fazat e vlerësimit.

Natyra e kontratës kornizë dhe struktura reale e paramasës

Aktiviteti konkret është **kontratë kornizë për mirëmbajtjen dhe servisimin e ashensorëve**, prandaj nuk mund të trajtohet sikur të ishte një kontratë e zakonshme furnizimi ku të gjitha pozicionet e listuara do të porositen dhe realizohen domosdoshmërisht.

Në paramasën e përgatitur nga vetë Autoriteti Kontraktues janë përfshirë **pothuajse të gjitha pjesët dhe komponentët kryesorë që përbëjnë një ashensor**.

Lista është aq gjithëpërfshirëse sa që, nëse këto pjesë do të porositeshin dhe bashkoheshin në tërësi, praktikisht do të mund të montohej ose rindërtohej pjesa dërmuese e një ashensori të ri.

Mirëpo, qëllimi i kësaj kontrate nuk është furnizimi me një ashensor të ri, por **mirëmbajtja dhe servisimi sipas nevojës**.

Pjesët janë përfshirë në paramasë në mënyrë që AK të ketë të përcaktuar paraprakisht çmimin për secilën pjesë, në rast se gjatë kohëzgjatjes së kontratës lind nevoja reale për zëvendësimin e saj.

Kjo nuk nënkupton se të gjitha pjesët do të porositen.

Përkundrazi, shumica e këtyre komponentëve mund të mos kenë nevojë të ndërrohen fare gjatë gjithë kohëzgjatjes së kontratës. Disa prej tyre mund të mos kenë nevojë për zëvendësim asnjëherë gjatë jetës së zakonshme të ashensorit, ndërsa komponentë të tjerë mund të funksionojnë për 10, 15 apo edhe 20 vite pa u zëvendësuar.

Për këtë arsye, **mbledhja aritmetike e çmimit për një njësi të secilës prej këtyre pjesëve dhe trajtimi i shumës 43,173.60 € si “vlerë reale e ofertës” nuk pasqyron mënyrën reale të realizimit të kontratës**.

Një llogaritje e tillë krijon artificialisht supozimin sikur AK gjatë periudhës së kontratës do të porosisë nga një njësi të pothuajse çdo pjese të ashensorit.

Nëse do të ndodhte kjo, atëherë nuk do të bëhej më fjalë për mirëmbajtje të zakonshme, por për një furnizim masiv me komponentë që të marrë së bashku do të përbënin praktikisht një ashensor tjetër.

Metodologjia e vlerësimit me çmim të peshuar

Pikërisht për shkak se në një kontratë të tillë nuk mund të dihet paraprakisht se cilat pjesë do të nevojiten dhe me çfarë frekuence, vetë legjislacioni i prokurimit publik parasheh përdorimin e **peshimit të çmimeve**.

Neni 17.35 i Rregullores për Prokurimin Publik përcakton se kur AK nuk i di sasi të indikative, në kontratat me çmime për njësi duhet të përcaktojë peshët në bazë të rëndësisë së secilës kategori të shërbimeve ose artikujve, me qëllim që të përcaktohet oferta me çmimin më të ulët.

Po ashtu, Neni 27.12 i Rregullores përcakton se në kontratat me çmime për njësi dhe në kontratat kornizë ku sasia e saktë nuk mund të llogaritet paraprakisht, AK duhet të vlerësojë **frekuencën dhe rëndësinë e secilës kategori** dhe të peshojë çmimin në bazë të kësaj rëndësie.

Në aktivitetin konkret, vetë AK ka përcaktuar tri kategori me peshë:

50%

30%

20%

Pas aplikimit të këtyre peshëve, oferta e EJONA SH.P.K. rezulton me **çmim total të peshuar prej 12,929.19 €**.

Pra, çmimi i peshuar nuk është zgjedhur nga EJONA SH.P.K., por është metodologji e përcaktuar nga vetë Autoriteti Kontraktues dhe e zbatuar për të gjithë operatorët ekonomikë.

Veçanërisht, Udhëzuesi Nr. 002/2024 për Plotësim-Ndryshimin e Udhëzuesit Nr. 001/2023 për Prokurimin Publik, në Nenin 12.4, përcakton shprehimisht se totali i çmimit për njësi i peshuar për të gjitha kategoritë shënohet në Procesverbalin e Hapjes së Tenderëve dhe në Raportin e Vlerësimit të Tenderëve dhe “merret për bazë gjatë vlerësimit të tenderëve. Prandaj, në një kontratë publike kornizë me çmime për njësi dhe poentim, baza e vlerësimit është çmimi total i peshuar, e jo mbledhja e thjeshtë aritmetike e çmimeve për njësi të të gjitha pozicioneve të paramasës.

Në aktivitetin konkret, çmimi total i peshuar i ofertës së EJONA SH.P.K. është 12,929.19 €, dhe pikërisht kjo vlerë është marrë për bazë në procesin e hapjes dhe renditjes së ofertave. Për rrjedhojë, përdorimi i shumës së papeshuar prej 43,173.60 € vetëm për qëllim të eliminimit tonë bie në kundërshtim me metodologjinë e përcaktuar për këtë lloj kontrate dhe me vetë rregullin që përcakton se çmimi i peshuar merret për bazë gjatë vlerësimit.

Kundërthënia me vendimin e parë të AK-së

Kjo bëhet edhe më e qartë nga fakti se në **vendimin e parë**, AK tashmë e kishte shqyrtuar të njëjtën ofertë financiare të EJONA SH.P.K. dhe e kishte konsideruar atë të përgjegjshme.

Mes vendimit të parë dhe vendimit të dytë:

oferta jonë nuk ka ndryshuar;
çmimet për njësi nuk kanë ndryshuar;
paramasa nuk ka ndryshuar;
peshat 50% / 30% / 20% nuk kanë ndryshuar;
shuma 43,173.60 ka qenë e njohur për AK edhe në vlerësimin e parë.

Megjithatë, vetëm pasi OE UP LIFT është eliminuar për shkak të kërkesës sonë për rishqyrtim, AK ka ndryshuar vlerësimin e ofertës sonë dhe e ka përdorur këtë shumë si bazë për eliminim dhe anulim të aktivitetit.

AK nuk ka identifikuar ndonjë fakt të ri që do ta arsyetonte këtë ndryshim.

Për këtë arsye, konsiderojmë se AK ka për detyrë të shpjegojë bindshëm se si një ofertë që ishte **e përgjegjshme në vendimin e parë**, pa ndryshuar asnjë element të saj, bëhet e papërgjegjshme vetëm gjatë rivlerësimit.

Referimi në Vendimin OSHP nr. 2025/1052

Në vendimin mbi kërkesën tonë për rishqyrtim, AK i referohet Vendimit të OSHP-së nr. **2025/1052**, duke e trajtuar atë si rast identik.

Mirëpo, vetë gjendja faktike e dy aktiviteteve nuk është identike.

Në rastin OSHP 2025/1052, për një vlerë të parashikuar prej **150,000.00** , shuma e çmimeve të papeshuara ishte **512,361.14** , pra më shumë se 3.4 herë vlera e parashikuar.

Vetëm kategoria me peshë 30% kishte shumën e çmimeve prej **469,597.40** ndërsa pjesa e buxhetit që i korrespondonte asaj kategorie ishte vetëm **45,000.00** .

Në aktivitetin konkret, struktura është dukshëm ndryshe.

Tabela II ka peshë **30%**. Nga vlera e parashikuar prej 27,000.00 , kësaj tablele i korrespondon:

$$27,000.00 \times 30\% = 8,100.00$$

Ndërsa shuma e çmimeve për njësi të EJONA SH.P.K. në këtë tabelë është **39,104.70** .

Raporti është:

$$8,100.00 / 39,104.70 = 20.71\%$$

Në rastin OSHP 2025/1052, raporti për kategorinë përkatëse ishte vetëm rreth **9.58%**.

Pra, edhe nëse për qëllime krahasimi përdoret metodologjia e njëjtë e përdorur në atë vendim të OSHP-së, gjendja faktike nuk është identike.

Për më tepër, në aktivitetin konkret, Tabela II përmban dhjetëra pjesë të ndryshme individuale të ashensorëve, të cilat nuk përbëjnë një furnizim të vetëm që duhet të realizohet në tërësi, por porositen vetëm sipas nevojës faktike.

Prandaj, referimi i përgjithshëm në Vendimin OSHP nr. 2025/1052 nuk është i mjaftueshëm për ta konsideruar automatikisht rastin konkret si identik dhe nuk e liron AK-në nga detyrimi për të bërë analizë konkrete të:

natyrës së kontratës kornizë;
strukturës së paramasës;
peshave të përcaktuara;
frekuencës së pritshme të kategorive;
dhe mënyrës reale të realizimit të pjesëve dhe shërbimeve.

Përfundim

Konsiderojmë se eliminimi i OE **EJONA SH.P.K.** është i pabazuar dhe nuk pasqyron natyrën reale të kontratës.

Shuma **43,173.60** nuk paraqet domosdoshmërisht vlerën që do të realizohet gjatë kontratës, por vetëm shumën matematikore të çmimeve për njësi të pothuajse të gjitha pjesëve të mundshme të ashensorëve të përfshira në paramasë për eventualitetin që ndonjëra prej tyre të nevojitet.

Në realitet:

kontrata është kornizë;
furnizimet dhe servisimet realizohen sipas nevojës;
pothuajse të gjitha pjesët e ashensorit janë përfshirë në paramasë;
shumë prej tyre mund të mos zëvendësohen asnjëherë;
vetë AK ka përcaktuar peshimin 50% / 30% / 20%;
çmimi i peshuar i ofertës sonë është **12,929.19** ;
dhe e njëjta ofertë është konsideruar e përgjegjshme në vendimin e parë të AK-së.

Për këto arsye, kërkojmë nga OSHP që të konstatojë se eliminimi i OE **EJONA SH.P.K.** nuk është mbështetur në një vlerësim të drejtë dhe të plotë të ofertës dhe natyrës së kontratës kornizë, të anulojë vendimin e kontestuar në këtë pjesë dhe ta kthejë aktivitetin në rivlerësim duke trajtuar ofertën tonë në përputhje me metodologjinë e përcaktuar në

Dosjen e Tenderit dhe legjislacionin në fuqi.

PRETENDIMI NR. 2

Mosshqyrtimi dhe mosverifikimi nga AK i dokumentacionit të z. Fatjon Beqa dhe pretendimit për shkeljen e Deklaratës nën Betim

Në kërkesën tonë për rishqyrtim kemi theksuar gjithashtu se z. **Fatjon Beqa nuk është paraqitur rastësisht në dokumentacionin e OE UP LIFT**, por është përfshirë në **listën e stafit për kryerjen e punëve të aktivitetit konkret të prokurimit**, ku lista përmban shprehimisht **emrin dhe numrin e këtij aktiviteti të prokurimit**.

Kjo është veçanërisht relevante për faktin se në Dosjen e Tenderit ishte përcaktuar kërkesa për **inxhinier të makinerisë**, ndërsa z. Fatjon Beqa është përfshirë nga OE UP LIFT në listën e stafit të paraqitur për këtë aktivitet.

Pra, nuk kemi të bëjmë vetëm me dorëzimin e dokumenteve të tij si dokumente të përgjithshme të kompanisë, por me **paraqitjen konkrete të tij si pjesë e stafit të angazhuar për realizimin e këtij aktiviteti të prokurimit**.

Në të njëjtën kohë, marrëveshja e bashkëngjitur për z. Fatjon Beqa i referohet një aktiviteti tjetër të prokurimit dhe në Nenin 13 kufizon përdorimin e diplomës, licencës dhe CV-së vetëm për atë aktivitet. Për më tepër, vetë z. Fatjon Beqa ka konfirmuar me email se **nuk ka marrëveshje paraprake me UP LIFT për aktivitetin në fjalë**.

Kjo krijon një kundërthënie të drejtpërdrejtë ndërmjet:

listës së stafit të dorëzuar nga OE UP LIFT për aktivitetin konkret;
dokumentacionit të bashkëngjitur për inxhinierin;
dhe deklaramit të vetë inxhinierit.

Pikërisht për këtë arsye kemi kërkuar nga AK që të verifikojë nëse OE UP LIFT ka pasur bazë dhe autorizim të vlefshëm për ta paraqitur z. Fatjon Beqa si pjesë të stafit për realizimin e këtij aktiviteti dhe për të përdorur dokumentet e tij profesionale në ofertë.

Fakti se në DT kërkohej inxhinier i makinerisë e bën këtë çështje edhe më relevante, sepse përfshirja e tij në listën e stafit për këtë aktivitet nuk mund të trajtohet si e parëndësishme apo si dokumentacion pa efekt në ofertë.

Pikërisht kjo mospërputhje ka qenë arsyeja pse kemi kontaktuar drejtpërdrejt z. Fatjon Beqa, vetëm për të verifikuar nëse ekzistonte ndonjë marrëveshje ose autorizim tjetër për përfshirjen e tij dhe përdorimin e dokumenteve të tij në aktivitetin konkret.

Në përgjigjen e tij me email, z. Fatjon Beqa ka konfirmuar shprehimisht:

“Jo, për aktivitetin në fjalë, nuk kemi marrëveshje paraprake me kompaninë UPLIFT.”

Ky konfirmim është paraqitur si provë para Autoritetit Kontraktues.

AK nuk e ka trajtuar fare këtë pretendim në kërkesën e parë për rishqyrtim

Veçanërisht shqetësues është fakti se **Autoriteti Kontraktues, në vendimin mbi kërkesën tonë të parë për rishqyrtim, nuk është marrë fare me këtë pretendim, pavarësisht natyrës serioze të tij.**

AK nuk ka konstatuar nëse marrëveshja e dorëzuar ishte e vlefshme për aktivitetin konkret, nuk ka verifikuar nëse ekzistonte ndonjë autorizim tjetër i z. Fatjon Beqa, nuk ka kërkuar sqarim nga OE UP LIFT dhe nuk ka dhënë asnjë arsyetim lidhur me provat e paraqitura nga ne.

Kjo është veçanërisht e rëndësishme sepse pretendimi ynë **nuk kishte të bënte vetëm me plotësimin apo mosplotësimin e kriterit për staf profesional.**

Pretendimi ngrinte çështjen nëse një OE kishte paraqitur në ofertën e tij një person dhe dokumentet e tij profesionale për një aktivitet për të cilin vetë personi deklaronte se nuk kishte marrëveshje me atë OE.

Rrjedhimisht, pretendimi ngrinte edhe çështjen e **saktësisë dhe vërtetësisë së dokumentacionit të paraqitur në tender dhe respektimit të Deklaratës nën Betim.**

Pavarësisht kësaj, AK në vendimin e parë nuk ka bërë asnjë analizë të kësaj çështjeje.

Pretendimi është ngritur përsëri në kërkesën e dytë për rishqyrtim

Pikërisht për shkak se AK nuk e kishte trajtuar fare në vendimin e parë, OE EJONA SH.P.K. është detyruar që **të njëjtin pretendim ta ngrisë përsëri në kërkesën e dytë për rishqyrtim.**

Edhe në këtë rast kemi kërkuar shprehimisht nga AK që të bëjë verifikimin dhe të konstatojë nëse OE UP LIFT kishte pasur autorizim të vlefshëm për:

- përfshirjen e z. Fatjon Beqa në listën e stafit për aktivitetin konkret;
- përdorimin e diplomës së tij;
- përdorimin e licencës së tij;
- përdorimin e CV-së së tij;
- dhe paraqitjen e këtyre dokumenteve si pjesë të ofertës.

Megjithatë, edhe pas kërkesës së dytë, **AK përsëri nuk e ka verifikuar pretendimin në substancë.**

Këtë herë AK ka deklaruar se nuk e ka parë të arsyeshme të bëjë verifikimin e dokumenteve, për faktin se OE UP LIFT tashmë ishte eliminuar për një arsye tjetër.

Ky arsyetim, sipas nesh, është i papranueshëm.

Eliminimi i OE për një arsye tjetër nuk e eliminon detyrimin për shqyrtimin e një pretendimi për dokumentacion potencialisht të pasaktë

Fakti se OE UP LIFT është eliminuar për shkak të çmimeve 0.00 **nuk e zgjidh dhe nuk e bën të parëndësishme çështjen e dokumentacionit të paraqitur në ofertë.**

Nëse një OE paraqet në një procedurë prokurimi dokumentacion të një personi për të cilin ekzistojnë prova konkrete se nuk ka dhënë pëlqimin për aktivitetin konkret, atëherë çështja nuk kufizohet vetëm në atë nëse OE e plotëson kriterin teknik me atë person.

Çështja prek drejtpërdrejt vërtetësinë e informatave dhe dokumentacionit të paraqitur në ofertë dhe Deklaratën nën Betim.

Për këtë arsye, konsiderojmë veçanërisht shqetësues faktin që një Autoritet Kontraktues si **Këshilli Prokurorial i Kosovës**, pasi është njoftuar jo një herë, por **dy herë**

për një pretendim të tillë dhe pasi i janë paraqitur prova konkrete, ka zgjedhur të mos e verifikojë atë.

Në kërkesën e parë pretendimi praktikisht është **anashkaluar tërësisht.**

Në kërkesën e dytë, AK ka pranuar se nuk e ka bërë verifikimin, duke e konsideruar të panevojshëm vetëm sepse OE UP LIFT tashmë ishte eliminuar.

Konsiderojmë se kjo nuk përbën shqyrtim të pretendimit në substancë.

Lidhja me Deklaratën nën Betim

Çështja bëhet edhe më serioze duke pasur parasysh se dokumentacioni në fjalë është

paraqitur si pjesë e ofertës së OE UP LIFT, së bashku me **Deklaratën nën Betim**.

Nëse nga verifikimi rezulton se z. Fatjon Beqa nuk ka pasur marrëveshje apo nuk ka dhënë autorizim për përfshirjen e tij dhe përdorimin e dokumenteve të tij në aktivitetin konkret, atëherë duhet të shqyrtohet nëse paraqitja e këtij dokumentacioni është në përputhje me deklaratimet dhe përgjegjësitë e marra nga OE përmes Deklaratës nën Betim.

Ne nuk kërkojmë që OSHP të konstatojë paraprakisht, pa verifikim, se OE UP LIFT ka dorëzuar dokumentacion të rremë. Pikërisht e kundërta: kërkojmë që kjo çështje të verifikohet në mënyrë të plotë dhe objektive.

Mirëpo, konsiderojmë se ekzistojnë prova të mjaftueshme që e bëjnë një verifikim të tillë të domosdoshëm: marrëveshja e dorëzuar lidhet me aktivitet tjetër, Neni 13 kufizon përdorimin e dokumenteve dhe vetë inxhinieri ka konfirmuar me shkrim se nuk ka marrëveshje paraprake me UP LIFT për aktivitetin konkret.

Për këto arsye, kërkojmë nga OSHP që ta shqyrtojë këtë pretendim në substancë dhe të konstatojë se **AK nuk e ka trajtuar dhe verifikuar në mënyrë të duhur as në kërkesën e parë dhe as në kërkesën e dytë për rishqyrtim**, si dhe të urdhërojë verifikimin e plotë të dokumentacionit dhe, varësisht nga rezultati i këtij verifikimi,

trajtimin e çështjes edhe në raport me **Deklaratën nën Betim dhe dispozitat përkatëse të legjislacionit të prokurimit publik**.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, në rast se përfshini pretendime për kompensim.

Si pasojë e veprimeve dhe vendimeve të Autoritetit Kontraktues, OE EJONA SH.P.K. është dëmtuar dhe vazhdon të rrezikojë të pësojë dëme materiale dhe ekonomike të drejtpërdrejta.

Në vendimin fillestar të AK-së, oferta jonë ishte konsideruar e përgjegjshme, ndërsa kontrata nuk na ishte dhënë vetëm për faktin se OE UP LIFT ishte renditur me çmim më të ulët. Pas kërkesës sonë për rishqyrtim, është konstatuar se OE UP LIFT duhet të eliminohet, mirëpo në vend që procedura të vazhdonte me ofertën tonë të konsideruar më parë të përgjegjshme, AK ka ndryshuar vlerësimin ndaj EJONA SH.P.K. dhe ka eliminuar edhe ofertën tonë.

Si rezultat, OE EJONA SH.P.K. është privuar nga mundësia reale për dhënien dhe realizimin e kontratës, përkatësisht nga të hyrat dhe fitimi i ligjshëm që do të mund të realizoheshin gjatë ekzekutimit të kontratës kornizë.

Përveç humbjes së mundësisë për realizimin e kontratës, kemi bartur dhe vazhdojmë të bartim shpenzime të lidhura drejtpërdrejt me pjesëmarrjen dhe mbrojtjen e interesit tonë në këtë aktivitet, përfshirë përgatitjen e ofertës, angazhimin e stafit profesional dhe administrativ, përgatitjen dhe administrimin e dokumentacionit, si dhe shpenzimet e procedurave të rishqyrtimit dhe ankimimit.

Dëmi potencial bëhet edhe më i rëndë për faktin se anulimi i aktivitetit e privon

EJONA SH.P.K. nga mundësia për t'u trajtuar si ofertuesi i mbetur i përgjegjshëm, ndonëse në vendimin fillestar AK vetë kishte konstatuar përgjegjshmërinë e ofertës sonë.

Për këtë arsye, konsiderojmë se ekziston lidhje e drejtpërdrejtë ndërmjet shkeljeve të pretenduara, eliminimit të ofertës sonë dhe dëmit material që na është shkaktuar apo që rrezikon të na shkaktohet. Kërkojmë nga OSHP që, përmes anulimit të vendimit të kontestuar dhe rivlerësimit të ligjshëm të aktivitetit, të parandalojë shkaktimin e mëtejshëm të këtij dëmi.

10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
- b) një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.*
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës së tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,*
- e) bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se,*
- f) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe*
- g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.*

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*